

KIRFN Interpretimi 6

Detyrimet që Rrjedhin nga Pjesëmarrja në një Treg Specifik— Mbetjet e Paisjeve Elektrike dhe Elektronike

KIRFN 6 Detyrimet që Rrjedhin nga Pjesëmarrja në një Treg Specifik— Mbetjet e Paisjeve Elektrike dhe Elektronike është zhvilluar nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve për raportimin Financiar dhe është publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në shtator 2005.

PËRMBAJTJA

paragrafët

KIRFN INTERPRETIMI 6

***DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA PJESËMARRJA NË NJË TREG
SPECIFIK — MBETJET E PAISJEVE ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE***

REFERENCAT

INFORMACION BAZË	1–5
OBJEKTI	6–7
ÇËSHTJA	8
KONSENSUSI	9
DATA E HYRJES NË FUQI	10
TRANZICIONI	11
BAZA PËR KONKLuzionET	

KIRFN Interpretimi 6 *Detyrimet që Rrjedhin nga Pjesëmarrja në një Treg Specifik— Mbetjet e Paisjeve Elektrike dhe Elektronike* (KIRFN 6) është parashtruar në paragrafët 1–11. KIRFN 6 shoqërohet nga një Bazë për konkluzione. Objekti dhe autoriteti i Interpretimeve jepen në paragrafët 1 dhe 8–10 të KIRFN-së *Parathënie*.

KIRFN Interpretimi 6

Detyrimet që Rrjedhin nga Pjesëmarrja në një Treg Specifik— Mbetjet e Paisjeve Elektrike dhe Elektronike

Referencat

- SNK 8 *Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*
- SNK 37 *Provizionet, Pasivet dhe Aktivitet Eventuale*

Informacion Bazë

- 1 Paragrafi 17 i SNK 37 specifikon që një ngjarje detyruese është një ngjarje e shkuar që krijon një detyrim aktual për të cilin një njësi ekonomike nuk ka asnjë alternativë tjetër, veçse ta shlyejë atë.
- 2 Paragrafi 19 i SNK 37 shprehet se provizionet njihen vetëm për 'detyrimet që lindin nga ngjarje të shkuara që ekzistojnë pavarësisht nga veprimet e njësisë ekonomike në të ardhmen'.
- 3 Direktiva e Bashkimit Europian mbi pajisjet elektrike dhe elektronike të nxjerra nga përdorimi (PE&ENP), e cila rregullon grumbullimin, trajtimin, rikuperimin dhe sistemimin për efekt mjedisor të këtyre pajisjeve, i jep shkas pyetjes se kur duhet të njihet detyrimi për nxjerrjen e tyre nga përdorimi. Direktiva bën dallimin midis nxjerrjes nga përdorimi 'të re' dhe asaj 'historike' dhe midis nxjerrjes nga përdorimi të pajisjeve shtëpiake vetjake dhe asaj nga burime të tjera. Nxjerrja e re nga përdorimi ka të bëjë me produktet e shitura pas 13 gushtit 2005. Të gjitha pajisjet shtëpiake të shitura para kësaj date krijojnë shpërdorime historike për efekt të Direktivës.
- 4 Direktiva përcakton se kostoja e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi i pajisjeve shtëpiake historike duhet të përballohet nga prodhuesit e asaj lloj pajisjeje që është në treg gjatë një periudhe që specifikohet në legjislacionin përkatës të secilit prej shteteve anëtare (periudha e matjes). Direktiva përcakton që secili prej shteteve anëtare të vendosë një mekanizëm që prodhuesit të kontribuojnë në kosto në mënyrë përpjesëtimore 'p.sh. në përpjesëtim me pjesën e tyre përkatëse të tregut sipas llojit të pajisjes.'
- 5 Disa nga termat e përdorur në Interpretim si 'pjesë tregu' dhe 'periudhë matjeje' mund të përkufizohen në mënyra të ndryshme në legjislacionin e zbatueshëm nga shtetet anëtare të veçanta. Për shembull, kohëzgjatja e periudhës së matjes mund të jetë një vit ose vetëm një muaj. Në mënyrë të ngjashme, matja e pjesës së tregut dhe formula e llogaritjes së detyrimit mund të jetë e ndryshme në shumë prej legjislacioneve kombëtare. Megjithatë, të gjithë këta shembuj prekin vetëm matjen e pasivit, i cili nuk është brenda objektit të Interpretimit.

Objekti

- 6 Ky Interpretim jep udhëzimin mbi njohjen, në pasqyrat financiare të prodhuesve, të pasiveve që kanë të bëjnë me drejtimin e nxjerrjes nga përdorimi sipas Direktivës së BE-së mbi PE&ENP, përsa i përket shitjeve të pajisjeve shtëpiake historike.
- 7 Interpretimi sqaron si nxjerrjet e reja nga përdorimi, ashtu dhe ato historike nga burime të ndryshme nga ato shtëpiake. Pasivi, që lind si rezultat i drejtimit të këtyre nxjerrjeve nga përdorimi, trajtohet mjaftueshëm në SNK 37. Megjithatë, nëse, në legjislacionin kombëtar, nxjerrjet e reja nga përdorimi të pajisjeve shtëpiake trajtohen në mënyrë të ngjashme me ato historike, parimet e Interpretimit zbatohen duke iu referuar hierarkisë në paragrafët 10–12 të SNK 8. Gjithashtu, hierarkia e SNK 8 vlen edhe për rregullimet e tjera që i ngarkojnë detyrimet në mënyrë të ngjashme me modelin e caktimit të koston siç specifikohet në Direktivën e BE-së.

Çështja

- 8 Në kontekstin e nxjerrjes nga përdorimi të PE&ENP, KIRFN-së iu kërkua të përcaktonte se çfarë përbënte ngjarje detyruese në përputhje me paragrafin 14(a) të SNK 37 për njohjen e një provizionit për kostot e drejtimit të këtyre nxjerrjeve:
 - prodhimi apo shitja e pajisjeve shtëpiake historike?
 - pjesëmarrja në treg gjatë periudhës së matjes?

- kostot e ndodhura gjatë kryerjes së aktiviteteve të drejtimit të nxjerrjeve nga përdorimi ?

Konsensusi

- 9 Në përputhje me paragrafin 14(a) të SNK 37, pjesëmarrja në treg gjatë periudhës së matjes është ngjarje detyruese. Si rrjedhim, një pasiv për kostot e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi të pajisjeve shtëpiake historike nuk lind kur produktet prodhohen ose shiten. Meqë detyrimi për pajisjet shtëpiake historike është i lidhur me pjesëmarrjen në treg gjatë periudhës së matjes, se sa me prodhimin ose shitjen e zërave për t'u nxjerrë nga përdorimi, nuk ka asnjë detyrim nëse dhe derisa ky treg nuk ekziston gjatë periudhës së matjes. Gjithashtu, kohëzgjatja e ngjarjes detyruese mund të jetë e pavarur nga periudha e veçantë në të cilën ndërmerren aktivitetet e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi dhe kostot përkatëse të ndodhura.

Data e hyrjes në fuqi

- 10 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 dhjetor 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim për një periudhë që fillon përpara datës 1 dhjetor 2005, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Periudha kalimtare

- 11 Ndryshimet në politikat kontabël do të trajtohen në përputhje me SNK 8.

Baza për konkluzionet mbi Interpretimin 6 të KIRFN-së

Kjo Bazë për konkluzione shoqëron KIRFN 6, por nuk është pjesë e tij.

- BC1 Kjo Bazë për konkluzione përmbledh përpjekjet e KIRFN-së për të arritur konsensusin. Disa anëtarë të KIRFN-së i dhanë më tepër rëndësi disa faktorëve se disa të tjerëve.
- BC2 KIRFN ishte informuar se Direktiva e Bashkimit Europian mbi pajisjet elektrike dhe elektronike të nxjerra nga përdorimi (PE&ENP), shtronte çështjen se kur duhet të njihet një pasiv për nxjerrjen nga përdorimi të këtyre pajisjeve. Prandaj KIRFN vendosi të zhvillojë një Interpretim që do të jepte udhëzimin në lidhje me atë që përbën një ngjarje detyruese në rrethanat e përshkruara nga Direktiva.
- BC3 Propozimet e KIRFN-së janë dhënë në Projektinterpretimin P10 *Detyrimet që Rrjedhin nga Pjesëmarrja në një Treg Specifik— Mbetjet e Paisjeve Elektrike dhe Elektronike*, që u publikua në nëntor 2004. Për këto propozime, KIRFN mori 22 letra me komente.
- BC4 Direktiva tregon se është pjesëmarrja në treg gjatë periudhës së matjes që krijon detyrimin për të kryer kostot e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi.
- BC5 Për shembull, një njësi ekonomike që shet pajisje elektrike në vitin 20X4, zotëron një pjesë tregu në masën 4 përqind për këtë vit kalendarik. Rrjedhimisht, ajo ndërpret aktivitetet dhe kështu nuk është më në treg, kur kostot e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi të produkteve të saj shpërndahen ndërmjet atyre njësisë ekonomike që ndodhen në treg në vitin 20X7. Në këtë vit, detyrimi i njësisë ekonomike është zero, meqë pjesa e tregut të saj është 0 përqind. Megjithatë, nëse njësi ekonomike hyn në tregun e produkteve elektronike në 20X7 dhe arrin të ketë 3 përqind të tij në këtë periudhë, atëhere detyrimi i njësisë ekonomike për kostot e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi për periudhat më të hershme do të jetë 3 përqind i këtyre kostove totale të shpërndara në 20X7, edhe pse njësi ekonomike nuk ka qenë në treg në këto periudha më të hershme dhe nuk ka prodhuar produkte të cilave u shpërndahen kostot e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi në këtë vit.
- BC6 KIRFN arriti në përfundimin se efekti i modelit të caktimit të kostos i specifikuar në Direktivë është, që shitja e cila bëhet gjatë periudhës së matjes, është 'ngjarje e shkuar' që duhet të njihet si një provizion sipas SNK 37 *Provizionet, Pasivet dhe Aktivitetet e kushtëzuara* gjatë kësaj periudhe. Totali i shitjeve për periudhën përcakton detyrimin e njësisë ekonomike për një pjesë të kostove të drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi të shpërndara për këtë periudhë. Periudha e matjes është e pavarur nga periudha kur bëhet shpërndarja e kostos tek pjesëmarrësit e tregut. Gjithashtu, kohëzgjatja e ngjarjes detyruese mund të jetë e pavarur nga periudha e veçantë në të cilën ndërmerren aktivitetet e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi dhe kostot përkatëse të ndodhura. Marrja përsipër e kostove në kryerjen e aktiviteteve të drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi është një çështje më vete që nuk ka të bëjë me lindjen e detyrimit për pjesën në koston përfundimtare të këtyre aktiviteteve.
- BC7 Disa nga të interesuarit kërkuar që KIRFN të shqyrtonte efektin e legjislacionit kombëtar vijues të mundshëm: kostot e drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi, për të cilat një prodhues është përgjegjës për shkak të pjesëmarrjes në treg gjatë periudhës së specifikuar (për shembull 20X6), nuk bazohen në pjesën e tregut të prodhuesit gjatë kësaj periudhe, por në pjesëmarrjen e tij në treg gjatë periudhës së mëparshme (për shembull 20X5). KIRFN vuri në dukje se një gjë e tillë prek vetëm matjen e pasivit dhe ngjarja detyruese është përsëri pjesëmarrja në treg gjatë vitit 20X6.
- BC8 KIRFN tregoi kujdes nëse përfundimi i tij ishte në kundërshtim me parimin që njësi ekonomike do të vazhdojë të funksionojë në vijimësi. Nëse njësi ekonomike do të vazhdojë të funksionojë në të ardhmen, ajo i trajton këto kosto si kosto të ardhshme. Në lidhje me këto kosto të ardhshme, në paragrafin 18 të SNK 37 theksohet se 'Pasqyrat financiare paraqesin pozicionin financiar të një njësie ekonomike në fund të periudhës së saj të raportimit dhe jo pozicionin e saj të mundshëm në të ardhmen. Prandaj, nuk njihet asnjë provizion për kostot që nevojiten të kryhen me qëllim që njësi ekonomike të funksionojë në të ardhmen.'
- BC9 KIRFN mori në shqyrtim një argument që prodhimi ose shitja e produkteve për përdorim vetjak përbën një ngjarje të shkuar, që shkakton një detyrim konstruktiv. Pra, shpërndarja e kostove të drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi mbi bazën e pjesës së tregut do të ishte një problem matjeje, sesa njohjeje. Përkrahësit e këtij argumenti vënë theksin në përkufizimin e një detyrimi konstruktiv të dhënë në paragrafin 10 të SNK 37 dhe vënë në dukje se për të përcaktuar nëse veprimet e shkua të një njësie ekonomike krijojnë një detyrim, është e nevojshme të shqyrtohet nëse një ndryshim në praktikë është një alternativë realiste. Këta përkrahës mendonin se kur një njësi ekonomike do ta kishte të nevojshme të kryente ndonjë veprim jorealit, me qëllim shmangien e detyrimit, atëhere ekziston një detyrim konstruktiv dhe duhet të trajtohet kontabilisht.

- BC10 KIRFN e hodhi poshtë këtë argument, duke nxjerrë përfundimin se një synim i shpallur për të marrë pjesë në një treg, gjatë një periudhë matjeje të ardhshme, nuk krijon një detyrim konstruktiv për kostot e ardhshme të drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi. Në përputhje me paragrafin 19 të SNK 37, një provizion mund të njihet vetëm në lidhje me një detyrim që lind pavarësisht nga veprimet e ardhshme të njësisë ekonomike. Për pajisjet shtëpiake historike detyrimi krijohet vetëm nga veprimet e ardhshme të njësisë ekonomike. Nëse një njësi ekonomike nuk ka pjesë tregu në një periudhë të matjes, ajo nuk ka asnjë detyrim për kostot e nxjerrjes nga përdorimi në lidhje me produktet e këtij lloji që i ka prodhuar ose shitur paraprakisht dhe të cilat ndërkaq do të kishin krijuar një detyrim në këtë periudhë të matjes. Kjo gjë i diferencon kostot e nxjerrjes nga përdorimi, për shembull, nga ato të garancisë (shih Shembullin 1 në Shtojcën C tek SNK 37), që përfaqëson një detyrim ligjor edhe nëse njësia ekonomike del nga tregu. Rrjedhimisht, nuk ekziston asnjë detyrim për kostot e ardhshme të drejtimit të nxjerrjes nga përdorimi, deri në çastin kur njësia ekonomike merr pjesë në treg gjatë periudhës së matjes.

